

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit I.R., nga fshati ..., Komuna e Vitisë, kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.991/2016 të datës 09.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.07.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit I.R., nga fshati ..., Komuna e Vitisë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.991/2016 i datës 09.11.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.991/2016 të datës 09.11.2018, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit I.R., nga fshati ..., Komuna e Vitisë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë, me nr. A/02/173/2016, i datës 20.05.2016.

Kundër këtij aktgjykimit në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi I.R., nga fshati ..., Komuna e Vitisë, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe të ligjshme, ashtu që ta prishë aktgjykimin e ankimuar, dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje, ose ta aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, të drejtë dhe ligjore, duke anuluar në tërësi vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe të obligojë të paditurin që me vendim të veçantë t'ia njeh paditësit të drejtën e pagesës retroaktive të koeficientit 9.5, që nga viti i aprovimit me vendim të formës së prerë që nga viti 2005, deri me 1 korrik 2013, me kamatë 8 %.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, me vendimin A/02/173/2016 të datës 20.05.2016, nën pikën I të

dispozitivit të vendimit, e ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën me numër A/02/178/2016 të datës 19.04.2013, të parashtruar nga ankuesi I.R., dhe në riprocedurë me obligim gjyqësor për rishqyrtim sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me numër A.nr.922/2013, të datës 27.04.2016. Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, është vendosur që ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 28.06.2016, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në provat dhe dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës. Me arsyetim se vendimi i organit të shkallës së dytë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, sepse i njëjti është marrë pas vërtetimit të të gjitha fakteve relevante, dhe se është bazuar në dispozita të ligjore në fuqi, që përcaktojnë statusin e pozitës që e ka paditësi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë iu ka referuar dispozitave ligjore nga neni 130 të Ligjit Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative, me të cilin përcaktohet se “Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi”. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë iu ka referuar Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, përkatësisht nenit 8 par.2, me të cilin përcaktohet se “Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditëve nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”. Gjykata shkallës së parë me të drejtë i ka refuzuar si të pa bazuara pretendimet e palës paditëse se organi i paditur nuk ka analizuar me kujdes të gjitha provat në relacion me çështjen, pasi që në bazë të shqyrtimit të vendimit të kontestuar rezulton se organi i paditur ka shqyrtuar provat relevante për marrjen e vendimit lidhur me ankesën, dhe se vendimi i atakuar përmban edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ, ose në faktet e siguruara sipas nenit 84 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurit në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të kundërligjshme copy paste e ka

refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke vërtetuar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës A/02/173/2016, të datës 20.05.2016, për hudhjen poshtë si të palejuar të ankesës së paditësit, duke menduar se ankesa është pasafatshme. Këto pretendimet ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se organi i paditur drejtë ka vendosur kur ka hedhur poshtë ankesën e parashtruar nga ankuesi I.R., si të palejuar, sepse sipas organit të paditur, paditësi ka humbur afatin ligjor për realizimin e së drejtës së tij, për shkak se koeficienti 9.5 është aprovuar me datën 24.05.2011, ndërsa paditësi ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka bërë me datën 04.03.2013, që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat ligjore të lartcekura. Andaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar si i tillë është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë, dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet tjera ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërtshëm me vetveten dhe me arsyetimin e tij, se i njëjti nuk përmban arsytet e dhëna, dhe se ato arsye nuk i arsyetojnë as përafërsisht faktet relevante të cilat kanë qenë me rëndësi për gjykim të drejtë e të ligjshëm në këtë çështje juridike. Ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të pa bazuara, dhe të pa qëndrueshme për vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga organi i paditur, dhe gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsytet e mjaftueshme mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e papazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.97/2018, me datë 22.07.2019

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi